

**Albanisch****Informacion për punonjësit dhe punonjëset e pastrimit të ndërtesave****Rregullat e reja kundër Koronës për punonjësit**

Për shkak të ndryshimeve në Ligjin për Mbrojtjen nga Infeksioni, lejoheni të hyni në vendin e punës vetëm me dëshmi vaksinimi, dëshmi rikuperimi ose dëshmi të testimit negativ.

Këtë dëshmi duhet ta keni me vete gjatë gjithë orarit të punës, gjatë gjithë përdorimit të transportit publik dhe gjithashtu duhet ta paraqisni tek kontrollet. Me kërkesë të punëdhënësit tuaj, ju jeni të detyruar t'ia paraqisni këtë dëshmi. Ne ju lutemi me anë të kësaj rregulloreje ta bëni një gjë të tillë.

Nëse nuk e respektoni këtë dhe nuk paraqisni dëshmi vaksinimi dhe rikuperimi, ju duhet të paraqisni për çdo ditë pune, një test negativ Korone aktual, i cili është i vlefshëm për jo më shumë se 24 orë. Ju jeni vetë përgjegjës për marrjen e testeve. Vetë testimet nuk janë të mjaftueshëm. Për këtë ju mund të përdorni për shembull qendrën e testimit të qytetarëve.

Nëse nuk paraqisni një dëshmi vaksinimi, dëshmi rikuperimi ose dëshmi të testimit negativ, ju nuk mund ta ushtroni punën tuaj dhe për këtë arsye nuk keni të drejtë page. Nëse nuk keni të drejtë page, nuk keni gjithashtu të drejtë për vazhdim të pagës në rast sëmundje.

Nëse hyni në vendin e punës pa dëshmi vaksinimi, dëshmi rikuperimi ose dëshmi testimi, do të përballeni me një gjobë nga autoritetet e kontrollit.

Ju lutem na dërgoni sa më parë një kopje të dëshmisë tuaj të vaksinimit ose të dëshmisë së rikuperimit.

-----  
Vendi/Data

-----  
Nënshkrimi